



### VENDIM

*Nr. 22, Datë 16.02.2016*

### **PËR MIRATIMIN E AMENDIMIT TE NENIT 15 TË MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E ERE NR. 10 DATË 04.02.2015,**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit ndërmjet OST sh.a dhe OSHEE sh.a., deri në datë 30.06.2016 dhe relacionin përkatës të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

#### **Konstatohet se:**

- OST sh.a dhe OSHEE sh.a kanë lidhur në datë 30.12.2014, Marrëveshjen për Shërbimin e Transmetimit, me afat 1 (një) vjeçar, miratuar me vendimin e ERE nr. 10 datë 04.02.2015.
- Palët kanë nënshkruar bashkërisht amendimin e nenit 15 të marrëveshjes, për shtyrjen e afatit të saj deri në **30.06.2016**, siç parashikohet në marrëveshje, përpara përfundimit të afatit të saj, në datë 30.12.2015.
- Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjetik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij;

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

## **Vendosi:**

1. Miratimin e amendimit te nenit 15 Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit te lidhur ndërmjet OST sh.a dhe OSHEE sh.a., miratuar me vendimin e ERE nr. 10 datë 04.02.2015.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.